



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZI.Anr.80/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Nenad Lazic dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike-shtyllë e elektrike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 28.09.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ndërkaq subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 750 (shtatëqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 26.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 26.09.2017, në afërsi të objektit të Kuvendit Komunal “Shtëpia e Bardhë” në Prizren, monitoruesit e tyre kanë hasur në posterë të kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal të Prizrenit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të vendosur hapësira publik përkatësisht në shtyllë elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e rregullave zgjedhore në momentin që ka vendosur posterin e kandidatëve për anëtarë të kuvendit komunal në hapësirë publike- shtyllë elektrike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK, të datës 27.09.2017, kanë pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se shkelja është bërë nga aktivistët e painformuar mirë me rregullat zgjedhore dhe se pas pranimit të ankesës nga ana e PZAP-së, kanë ndërmarrë masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur një fotografi nga vendi ku është larguar posterit.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik PDK janë vendosur në shtyllë elektrike-hapësirë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatëve për anëtarë të kuvendit komunal të Komunës së Prizrenit nga subjekti politik PDK, janë vendosur në shtyllë elektrike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik PDK, në përgjigjen në ankesë të datës 26.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal të Prizrenit nga ky subjekti politik janë vendosur në shtyllë elektrike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr posterin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 80/2017 më datën 28.09.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

**Gyltene Sylejmani**

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së***

